

“Albania - Experience” sh.p.k

**Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**



8

PËRMBAJTJA:

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

2

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

3

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

4

PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË

5

SHËNIME TË PASQYRAVE FINANCIARE

6-17

1

(Vlerat janë në Lekë)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
Me 31 Dhjetor 2014**

	Shenime	<u>Dhjetor 31, 2014</u>	<u>Dhjetor 31, 2013</u>
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	4	2,485,399	7,548,546
Llogari të arkëtueshme	5	23,492,111	6,444,537
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	6	5,723,691	5,125,708
Llogari të tjera te arkëtueshme	7	7,313,121	1,972,685
Total Aktiveve Afatshkurtra		39,014,322	21,091,476
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	8	5,820,393	4,176,996
Aktive afatgjatë jomateriale		-	2,520,000
Huadhenie Afatgjatë	9	177,632,155	76,000,500
Total aktive afatgjatë		183,452,548	82,697,496
Total Aktive		222,466,870	103,788,972
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	10	93,539,494	
Llogari te pagueshme tregëtare	11	14,055,816	4,129,634
Detyrimet tatimore	12	674,127	817,925
Parapagime te arketuara	13	42,949,841	-
Llogari te pagueshme te tjera	14	591,113	505,364
Total Detyrime afatshkurtra		151,810,389	5,452,923
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë	15	26,911,523	74,122,068
Total Detyrime afatgjatë		26,911,523	74,122,068
Totali i detyrimeve		178,721,912	79,574,991
Kapitali aksionar			
Kapitali aksionar		100,000	100,000
Fitime te mbartura		24,113,981	22,263,956
Fitimi i ushtrimit	16	19,530,978	1,850,025
Total kapitali aksionar		43,744,959	24,213,981
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		222,466,870	103,788,972

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

(Vlerat janë në Lekë)

**Pasqyra e Te ardhurave dhe Shpenzimeve
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**

	Shenime	<u>Dhjetor 31, 2014</u>	<u>Dhjetor 31, 2013</u>
Te ardhura	17	638,763,411	365,097,079
Te ardhura te tjera		3,026,000	-
Materiale te para dhe te konsumeshme	18	(597,195,480)	(348,513,062)
Shpenzime personeli	19	(8,251,485)	(6,454,404)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	20	(1,447,821)	(947,839)
Shpenzime te tjera	21	(10,826,133)	(4,314,291)
Fitimi operativ		24,068,492	4,867,483
Te ardhurat/shpenzime financiare nga njesite e kontrolluara		-	(3,770,296)
Te ardhura/(Shpenzime) financiare Neto	22	(1,043,487)	1,232,302
Total shpenzime financiare		(1,043,487)	(2,537,994)
Fitimi para tatimit		23,025,005	2,329,489
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(3,494,027)	(479,464)
Fitimi i vitit		19,530,978	1,850,025

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Albania Experience Sh.p.k.
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014


(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Levizjeve të Kapitalit
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

	Kapitali aksionar	Fitime te mbartura /humbje te akumuluar	Fitim (Humbje) Ushtrimit	Totali
01 Janar 2013	(100,000)	-	(22,263,956)	(22,363,956)
Fitimi i vitit			(1,850,025)	(1,850,025)
Transferim ne fitime te mbartura		(22,263,956)	22,263,956	-
31 Dhjetor 2013	(100,000)	(22,263,956)	(1,850,027)	(24,213,981)
Transferim ne fitime te mbartura		(1,850,027)	1,850,027	-
Fitimi i vitit			(19,530,978)	(19,530,978)
31 Dhjetor 2014	(100,000)	(24,113,981)	(19,530,978)	(43,744,959)

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 u aprovuan nga Administratori i Albania-Experience sh.p.k. dhe u nënshkruan si më poshtë më 30 Mars 2015 nga:


Gazmend Haxhia
Administrator

Albania Experience Sh.p.k.
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Fluksit të Parasë
Më 31 Dhjetor 2014

Shenime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	23,025,005	2,329,489
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	1,447,821	947,839
Te ardhura nga shitja e Aktiveve Afatgjata Materiale		
Interesa te perllogaritura		
Shpenzime për interesa		
Diferenca konvertimi te perealizuara	-	
Fitimi operativ përpara ndryshimeve ne kapitalin qarkullues		
<i>Ndryshimi ne kapitalin qarkullues</i>		
Ndryshimi ne inventar		
Ndryshimi ne llogari te arketueshme dhe te tjera	(22,388,010)	3,354,219
Ndryshimi ne llogari te pagueshme dhe te tjera	8,221,233	(6,888,754)
Ndryshimi ne parapagime e shpenzime te shtyra	(597,983)	(5,125,708)
Ndryshimi ne te parapagime te arketueshme	42,949,839	35,813,180
Ndryshim ne te ardhura te shtyra	-	(10,120,131)
Mjetet monetare te gjeneruara nga aktivitetet operative	52,657,904	20,310,134
Interesa te paguara		
Tatimi mbi fitimin i paguar gjate vitit	(1,847,129)	(1,971,315)
	(1,847,129)	(1,971,315)
Aktivitetet investuese		
Blerje te aktiveve afatgjata material	(571,216)	(4,445,977)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale		
Ndryshime ne huadhenie afatgjata	(101,631,655)	(44,940,500)
Interesa te marra		
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti investues	(102,202,871)	(49,386,477)
Aktivitetet financuese		
(Ripagim)/ te hyrat neto nga huate	46,328,949	
Shtesa/pakesime ne qera financiare		
Dividendë paguar		
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti financues	46,328,949	
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(5,063,147)	(31,047,658)
Mjetet monetare ne fillim te periudhës	7,548,546	38,596,204
Mjetet monetare ne fund te periudhës	2,485,399	7,548,546

Pasqyra e fluksit të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



1. TË PËRGJITHSHME

"Albania – Experience " sh.p.k (Kompania) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 18.10.2005 ne perputhje me Ligjin nr. 9901, date 03.03.2008 "Mbi Shoqërite tregtare".

Kapitali i nenshkruar i shoqërise eshte 100,000 Lekë me perfaqesues ligjor: Z. Gazmend Haxhia

Objekti kryesor i Shoqërise ne treg eshte shitje bileta avioni, tragei dhe treni ne te gjitha destinacionet qe menaxhojne shoqërite perkatese, udhetime turistike ne te gjitha destinacionet turistike ne Shqiperi dhe ne bote, paketa turistike, Trekking, peshkim, gjueti, etj.

Nipti I kompanise eshte K6142204L .

Zyra qendrore e Shoqërisë ndodhet në Rrugen: "Themistokli Gërmenji", Tirane.

2. BAZAT E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Bazuar në SKK 11 "Tatimi mbi të Ardhurat", Shoqëria ka vendosur të mos kontabilizojë tatimet e shtyra mbi të ardhurat për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 KLIMA E BIZNESIT

Drejtimi nuk është në gjendje të përcaktojë në mënyrë të besueshme efektet në pozicionin financiar të ardhshëm të Shoqërisë ne rast të ndonjë përkeqësimi të mëtejshëm në mjedisin operacional të Shoqërisë si rezultat i krizës në vazhdim. Drejtimi i Shoqërisë beson se ka marë të gjitha masat e nevojshme për të mbështetur ruajtjen dhe zhvillimin e biznesit të Shoqërisë në kushtet aktuale.

Ndikimi tek konsumatorët/huamarrësit:

Debitorët e shoqërisë mund të ndikohen në mënyrë të pafavorshme nga mjedisi financiar dhe ekonomik i cili do të ndikonte në aftësinë e tyre për të paguar shumat e kërkuara. Përkeqësimi i kushteve ekonomike për konsumatorët mund të ketë gjithashtu efekt në parashikimet e drejtimit për flukset e ardhshme monetare dhe për vlerësimin e humbjes nga rënia në vlerë e aktiveve financiare dhe jo-financiare. Në masën që informacioni është i disponueshëm, drejtimi i Shoqërisë ka pasqyruar në mënyrë të përshtatshme përlogaritjet për flukset e pritshme monetare në vlerësimet për rënie në vlerë.



6

2.5 Biznesi ne vijimesi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë egzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.6 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken. Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumën e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

2.7 POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 është detajuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Kurset e këmbimit		
Euro/Lekë	140.14	140.20
Usd/Lekë	115.23	101.86

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

(Vlerat janë në Lekë)

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke Zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

3.3 Aktive afatgjata materiale

(Vlerat janë në Lekë)

i. Njohja dhe matja

Aktivët afatgjatë materiale paraqiten me kosto, duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe ndonjë rënie në vlerë. Amortizimi llogaritet mbi vlerën e mbetur të aktiveve, mbi bazën e normave të mëposhtme të amortizimit:

Mobilje dhe orëndi	20%
Pajisje kompjuterike	25%

Vlera e mbartur e aktiveve afatgjatë materiale rishikohen për zhvlerësim kur ngjarje apo ndryshime në rrethanat tregojnë se vlera kontabel mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, kur vlera kontabel tejkalon vlerën e rikuperueshme të vlerësuar aktivët paraqiten me vlerën e tyre të rikuperueshme, e cila është me e larta mes vlerës së tyre të drejte minus kostot për shitje dhe vlerës së tyre në përdorim.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjatë materiale njihet në vlerën kontabel të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjatë materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Amortizimi vjetor pasqyrohet në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve.

Shoqëria llogarit amortizimin e Aktiveve Afatgjatë Materiale bazuar në jetën e dobishme të tyre sipas gjykimit të manaxhimit.

Në përputhje me SKK nr. 5 paragrafi 41 sipas të cilit "Përshtatshmeria e normave të amortizimit, metodave të amortizimit dhe përlogaritjes së vlerave të rikuperueshme duhet të rishikohet rregullisht. Nëse konstatohet se jeta e dobishme aktuale e një aktiviteti afatgjatë material ndryshon dukshëm nga përlogaritja fillestare, periudha e amortizimit duhet të ndryshohet. Gjithashtu nëse është e nevojshme, duhet të ndryshohen metodat e amortizimit dhe zvogëlimi i vlerës së mbetur të përlogaritjes të një aktiviteti afatgjatë material. Efekti i ndryshimit të periudhës së amortizimit ose vlerës së rikuperimit do të kontabilizohet si ndryshim në vlerësimet kontabel, në përputhje me udhëzimet e SKK 1 (dmth në periudhën aktuale e ato të ardhshme, dhe jo në mënyrë retrospektive).

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Aktive afatgjatë jomateriale

Aktivët afatgjatë jomateriale njihen atëherë kur është e mundur që të përfitime ekonomike do të sigurohen në të ardhmen në lidhje me këto aktive dhe kostoja e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme. Të gjitha aktivët afat-gjatë jo-materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit.



(Vlerat janë në Lekë)

Shpenzimet e mevonshme kapitalizohen vetëm kur rrit përfitimet e ardhshme ekonomike të aktivitetit. Të gjitha shpenzimet tjera, përfshirë shpenzimet për emrin e mirë të prodhuar vetë dhe të markave, njihet në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin. Shpenzimet lidhur me mirembajtjen e programeve kompjuterike software njihen si shpenzime në momentin kur ndodhin. Amortizimi llogaritet me metodën e masës 10% AAJM.

Kostot e software të njohura si aktive amortizohen gjatë jetës së tyre vlerësuar të përdorimit, që nuk i kalon katër vjet. Jetëgjatësia e asetëve është rishikuar, dhe rregullohet nëse është e përshtatshme, në çdo datë të bilancit. Fitimet dhe humbjet nga nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabël neto, dhe janë të përfshira në Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Huate

Huate e marra nga institucionet financiare nga shoqëria, janë mbajtur me koston e amortizuar duke përdorur interesin e aplikuar në kontratat e huave. Interesat e perlllogaritura janë njohur në pasqyrën e të ardhura-shpenzimeve dhe si detyrim në llogarinë e interesave të perlllogaritura. Huate e marra në monedhe të huaja janë rivilësuar me kursin zyrtar të këmbimit.

3.6 Marrja me Qira

Marrjet me qira (Qirate) klasifikohen si qira financiare (kapitali) ose qira operative që në fillimin e qirase. Qirate e financave (kapitalit) njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën me të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës së aktuale të minimumit të pagesave të qirase në datën e blerjes. Kostot e financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhura dhe shpenzimeve nën termin e qirase me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Pagesat e bëra për qiratë e zakonshme janë njohur në të ardhura ose shpenzime në mënyrë lineare gjatë afatit të qirasë. Lehtësirat e përfituara të qirasë janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimeve totale të qirasë, gjatë afatit të qirasë.

3.6 Provigjonet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.8 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3. POLITIKAT KONTABËL (vazhdim)

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura të interesit nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga intereset njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime të interesit mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i vitit është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë vitit.

4. MJETE MONETARE

Teprica e likuiditeteve për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Mjete monetare në Leke	<u>933,781</u>	<u>3,542,250</u>
Banka	854,001	1,019,120
Arka	79,780	2,523,130
Mjete monetare në valute	<u>1,551,618</u>	<u>4,006,295</u>
Banka	1,406,402	191,758
Arka	145,216	3,814,538
	<u><u>2,485,399</u></u>	<u><u>7,548,546</u></u>

5. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme përfaqësojnë detyrime të pa arkëtuara nga klientët në datën e mbylljes së Pasqyrave Financiare.

Llogaritë e arkëtueshme më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Kliente	<u>23,492,111</u>	<u>6,444,537</u>
	<u><u>23,492,111</u></u>	<u><u>6,444,537</u></u>

6. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TE SHTYRA

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Shpenzime të shtyra	<u>5,723,691</u>	<u>5,125,708</u>
	<u><u>5,723,691</u></u>	<u><u>5,125,708</u></u>

7. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME

Llogarite e tjera te arketueshme perbehen nga TVSH-ja per t'u rimbursuar nga leasing si dhe debitore te tjere, balanca e te cilave me 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 paraqitet si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Tvsh per t'u sistemuar (marredhenie Leasing)	322,943	544,880
Tatim Fitim	-	1,427,805
Debitore te tjere	6,990,178	-
	<u>7,313,121</u>	<u>1,972,685</u>

8. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE DHE JO-MATERILAE

	Licenca	Paisje kompjuterike	Paisje zyre	Totali
Kosto				
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	3,150,000	664,331	558,000	4,372,331
Shtesa		4,445,977		4,445,977
Gjëndja më 31 Dhjetor 2013	3,150,000	5,110,308	558,000	8,818,308
Shtesa	-	571,216	-	571,216
Gjëndja më 31 Dhjetor 2014	3,150,000	5,681,524	558,000	9,389,524
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	315,000	446,749	411,724	1,173,473
Amortizimi i vitit	315,000	603,584	29,255	947,839
Nxjerrje jashtë përdorimit				-
Gjëndja më 31 Dhjetor 2013	630,000	1,050,333	440,979	2,121,312
Amortizimi i vitit	315,000	1,109,417	23,404	1,447,821
Gjëndja më 31 Dhjetor 2014	945,000	2,159,750	464,383	3,569,133
Vlera neto kontabël				
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	2,835,000	217,582	146,276	3,198,858
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	2,520,000	4,059,975	117,021	6,696,996
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	2,205,000	3,521,774	93,617	5,820,393



(Vlerat janë në Lekë)

9. INVESTIME AFATGJATE

Kjo shume përfaqëson huatë afatgjata, balanca e te cilave me 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 paraqitet si me poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Investime afatgjata	177,632,155	76,000,500
	<u>177,632,155</u>	<u>76,000,500</u>

10. HUA AFATSHKURTRA

Ne kete ze jane paraqitur huatë afatshkurtra me Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Hua afat-shkurter	38,612,347
ODraft	54,927,147
	<u>93,539,494</u>

11. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitorëve për mallra e shërbime si me poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Llogari te pagueshme tregtare	14,055,816	4,129,634
	<u>14,055,816</u>	<u>4,129,634</u>

12. DETYRIME TATIMORE

Detyrimet tatimore më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Detyrime per sigurime shoqerore & shendetesore	135,374	120,228
Detyrime per tatimin mbi te ardhurat personale	17,980	27,292
TVSH per t'u paguar	301,679	670,404
Tatim fitimi	219,093	-
	<u>674,126</u>	<u>817,925</u>

13. PARAPAGIME TE ARKETUARA

Parapagimet e arketuara me 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 paraqitet si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Parapagime te arketuara	42,949,839	-
	<u>42,949,839</u>	<u>-</u>

Albania Experience Sh.p.k.
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lekë)

14. LLOGARI TE PAGUESHME TE TJERA

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Paga per t'u paguar	573,852	505,364
Te tjera	17,261	-
	<u>591,113</u>	<u>505,364</u>

15. HUA AFATGJATA

Ne kete ze jane paraqitur huate afat gjata me 31 Dhjetor 2014 dhe 2013:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Hua afat gjata	26,911,523	74,122,069
	<u>26,911,523</u>	<u>74,122,069</u>

16. KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën 100,000 Lekë.

Fitimi i ushtrimit

Shuma prej 19,085,096 Lekë perfaqeson fitimin e vitit te mbyllur më 31 Dhjetor 2014.

17. TË ARDHURAT

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013</u>
Te ardhura nga aktiviteti	638,763,412	365,097,079
Te ardhura te tjera	3,025,999	-
	<u>641,489,411</u>	<u>365,097,079</u>

Tabela me poshte perfaqeson rakordimin e te ardhurave me deklarimet e bera ne sistemin elektronik tatimor

	<u>Dhjetor 31, 2014</u>
Rakordimi i te ardhurave me FDP-ne	
Qarkullim i tatueshem	684,739,249
Parapagimet ne mbyllje te vitit	(42,949,839)
Shuma e qarkullimit e korrektuar	641,789,410
Sipas Kontabilitetit	641,789,410
Diferenca	<u>(0)</u>

(Vlerat janë në Lekë)

18. MATERIALE TE PARA DHE TE KONSUMUESHME

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013</u>
Materiale te para dhe te konsumueshme	597,195,480	231,638,877
	<u>597,195,480</u>	<u>231,638,877</u>

19. SHPENZIMET E PERSONELIT

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013</u>
Shpenzime per paga	7,302,040	5,768,312
Shpenzime per sigurime shoq e shend	949,445	686,092
	<u>8,251,485</u>	<u>6,454,404</u>

20. SHPENZIME ZHVLERËSIMI DHE AMORTIZIMI

Shpenzimet e amortizimit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013</u>
Shpenzime amortizimi	1,447,821	947,839
	<u>1,447,821</u>	<u>947,839</u>

21. SHPENZIME TË TJERA

Këto shpenzime janë analizuar në tabelën e mëposhtme:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014</u>
Shpenzime qeraje	500,000
Kancelari	513,809
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	672,721
Komisione bankare	2,821,781
Taksa te ndryshme	75,360
Gjoha te ndryshme	268,508
Shpenzime te tjera	5,973,954
	<u>10,826,133</u>

22. TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË TJERA FINANCIARE

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare jane analizuar si me poshte:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013
Shpenzime per interesa	(6,836,862)	(399)
Te ardhura nga interesat	-	284
Humbje nga kembimet valutore	(212,995)	(518,397)
Te ardhura nga kembimet valutore	6,006,371	1,750,815
	(1,043,487)	1,232,303

23. TATIMI MBI FITIMIN

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2013: 10%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruar për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Fitimi para tatimit	23,025,005	2,329,489
Shpenzime te panjohura (si me poshte)	268,508	2,465,151
Fitimi para tatimit (perfshire shpenzimet e panjohura)	23,293,513	4,794,640
Tatim fitimi @15% (10%-2013)	3,494,027	479,464
Fitim/(humbje) e vitit	19,530,978	1,850,025

26. ANGAZHIME DHE PASIGURI (VAZHDIM)

Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2014 Shoqëria nuk ka asnjë çeshtje gjyqesore te hapur kundrejt saj apo nga ajo, qe mund te kerkoje rregullime te ketyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

27. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

